REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 10.05.2022

Me datë 10.05.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër.Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija,Bledianë Nika, Teuta Zaja, Nersada Mandija, Aurora Dibra, Diana Muriqi, Jona Leqejza, Sabahete Lishi,Ardita Spahija,Dhurata Tyli,Age Martini, Valbona Doniku, Diandra Kraja, Lumnije Guri, Erion Metushi, Anton Kaftalli, Luan Heta, Hilmi Lakti, Marjan Ndershtiqaj, Gerald Hasaj, Lush Marku, Sokol Zaimaj, Anton Deda, Besmir Vukaj, Gjergj Sokoli,Andi Halluni,Luigj Palushi, Lindita_Nika, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Mars 2022".*

2. Pr/Vendim: *"Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar,të nënpunësve civilë e punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dheinstitucioneve të varësisë."*

3. Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB Nr.22,datë 18.04.2019 për miratimin e planit lokal për veprimin e zhurmës në njedis, Bashkia Shkodër."*

4. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të segmentit të rrugës "Hallunaj" në Rruga e "Tenisit", Njësia Administrative Rrethina"*

5. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të segmentit të rrugës "Justin Godart" në Rruga "Gjosho Vasija".*

6. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të segmentit të rrugës "Lekaj"në Rruga "Mirash Zef Preka",njësia Administrave Shalë."*

7. Pr/Vendim: *"Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë konviktit të shkollës veterinare të Bashkisë Shkodër".*

8. Pr/Vendim: *"Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira tek ish konvikti i shkollës veterinare dhe të rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër."*

9. Pr/Vendim: *"Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë qëndrës komunitare për familjen nr.6 dhe banesat me qira për komunitetin rom,për vitin 2022."*

10. Pr/Vendim: *"Për disa shtesa në VKB Nr.49,datë 30.10.2020 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave socisle me qira pranë qëndrës komunitare për familjen Nr.6."*

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, prandaj vijohet me hedhjen në votim të rendit të ditës.
Kryetarja e këshillit njofton se ka edhe një propozim për një shtesë në rend dite për një Pr/Vendim në lidhje me dhënie ndihme financiare për dëmë të shkaktuara nga zjarri.

Fjalën e merr Znj.Mandija ,e cila kërkon që pika 3 e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër me qëllim që të diskutohet në një dëgjesë publike me grupet e interesit duke vlerësuar rëndësinë e saj.

Hidhet në votim rendi i ditës me propozimet e parashtruara, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

1.Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Mars 2022"*

N/Kryetari i Bashkisë merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Znj.Mandija ,në emër të komisionit shprehet Pro. Edhe kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

2.Vijohet me Pr/Vendimin: *"Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar,të nënpunësve civilë e punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dheinstitucioneve të varësisë."*

Përsëri fjalën e merr N/Kryetari i Bashkisë i cili sqaron arsyen pse ky Pr/Vendim vjen përsëri në Këshill dhe thekson që pas diskutimeve dhe bashkëpunimit me Prefekturën ,ky Pr/akt vjen konform ligjit me ndryshimet përkatëse.

Fjalën e merr Znj.Leqejza,e cila propozon që Ne pikat 1-3 ku shprehet vendimarrja, te shtohet edhe nje pike ku cilesohet sa vijon: shfuqizohet VKB e meparshme saktesisht VKB nr 6 date 30.1.2018 mbi percaktimin e nivelit te pagave.

Tek tabela 1: te caktohet page fikse pra jo me nivele ne kufirin maksimal te parashikuar funksionet e sekretarit te keshillit dhe sekretarit te kryetarit te bashkise duke qene se jane role qe permbushen nga perkatesisht vetem nje person.

Tek paragrafi 5, I faqes 3 te relacionit mbeshtetes te projektvendimit te shtohet informacioni sa vijon:

E njejta kategori klasifikohet ne disa nivele pagash ne perputhje me neni 34 ligjin152/2013 I ndryshuar: per cdo klase miratohen dhe zbatohen disa hapa page ne rend rrites bazuar ne kriteret sa vijon: vjetersi ne sherbimin civil, rezultatet e performances ne pune, dhe perfundimin me sukses I veprimtarive te formitit profesional.

Gjithashtu kwshilltarja thekson se sa i perket komentimit cilesor mbi kete projekt akt dhe me gjere, sic citohet edhe ne ligj, performanca eshte nje kriter i rendesishem i vleresimit te nivelit te pages per punonjesin individualisht. Persa kohe ekziston nje kuader ligjor qe percakton modalitetet e vleresimit te performances ne shkalle strukturale dhe hierarkike, mungesa e dokumentave qe percaktojne standardet dhe normat te sherbimeve si ato organike si ato te deleguara dhe per rrjedhoje dhe mungesa e rregulloreve perkatese e lene te cunguar dhe pa substance vleresimin e performances individuale. Ne menyre qe te kemi nje sistem vleresimi me substancial mendojme se ka ardhur momenti qe bashkia te draftoje strategjine gjitheperfshirese per sherbime te rendesishme si arsimi parashkollor, pastrimi, sherbimet publike vendore, funksionet me karakter inspektues, dhe funksionet qe japin sherbim direkt te qytetari. Ne kete menyre merr udhe edhe percaktimi I rregulloreve te cilat do te sherbejne si per monitorimin e sherbimit ashtu edhe si mekanizma vleresimi te performances indivuale te punonjesve, e cila sherben shume per te vendosur nje sistem meritokracie dhe stimuli I cili ndikon drejtperdrejte ne cilesine e jetes te banoreve te Bashkise Shkoder.

Kryetarër e grupeve shprehen: Znj.Dibra mbështet miratimin e Pr/Aktit me ndryshimet dhe propozimet e sipërcituara nga komisioni.Gjithashtu edhe Z.Sokoli shprehet dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

Kryetarja e Këshillit ,sqaron se meqënëse tre Pr/Vendimet në vazhdim kanë të bëjnë me të njëjtën bazë ligjore,do relatohen një nga një por do hidhen në votim vecmas.

Z.Dedaj merr përsëri fjalën dhe relaton për të tre segmentet rrugorë qe do pesojnë ndryshim emri.

Z.Hallunaj,si pjesëtar i familjes Hallunaj shprehet dakort për ndryshimin e emrit të rrugës 'Hallunaj'në 'Rruga e Tenisit'.

3. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të segmentit të rrugës "Hallunaj" në Rruga e "Tenisit", Njësia Administrative Rrethina"* hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim. ***Miratohet***

4. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të segmentit të rrugës "Justin Godart" në Rruga "Gjosho Vasija".* hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim. ***Miratohet***

5. Pr/Vendim: *"Për miratimin e ndryshimit të segmentit të rrugës "Lekaj"në Rruga "Mirash Zef Preka",njësia Administrave Shalë."* hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim. ***Miratohet***

6. Vijohet me Pr/Vendim: *"Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë konviktit të shkollës veterinare të Bashkisë Shkodër".*

Relaton Z.Vila, drejtor i drejtorisë së Shërbimit Social dhe Strehimin ne bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata dhe jep sqarime të detajuara.

Merr fjalën Z.Mandija e cila vlerëson dhe shprehet dakord ne lidhje me Pr/aktin në emër të komisionit.

Znj.Petani merr fjalën dhe kërkon të dijë nga Z.Vila në lidhje me familjet e ish konviktit 'Safet Spahia'

Z.Vila përgjigjet se edhe në relacionin shoqërues, tregohet qartë që edhe familjet në fjalëdo jenë pjesë e listës që përfshihen në këtë Pr/ Vendim sepse konvikti do mbyllet përfundimisht dhe do kalojë në administrimin e bashkisë së Shkodrës.

Edhe Z.Sokoli kërkon të dijë se cfarë do bëhet me godinat e destinuara për familjet e komunitetit rom.

Z.Vila sqaron se godinat janë përfunduar, por kemi hasur pengesa në lidhje me energjinë elektrike dhe matësat. Prandaj deri sa të gjindet një zgjidhje ,nuk mund të vijohet me punën.Gjithashtu ai thekson se edhe konvikti i shkollës pyjore dhe 3 Godina të tjera janë në dispozicion të fëmijëve jetim dhe familjeve një prindërore me probleme ekonomike-sociale.

Kryetarët e grupeve shprehen Pro këtij Pr/Vendimi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

7.Vijohet me Pr/Vendim: *"Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira tek ish konvikti i shkollës veterinare dhe të rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër."*

Edhe në lidhje me këtë Pr/Vendim Znj.Mandija në emër të komisionit shprehet për rëndësinë e tij dhe pranon vështërsitë që do hasen në zbatimin e tij.Megjithatë shpreh dakortësi.Edhe Kryetarët e grupeve janë pro këtij projekt akti . Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

8. Vijohet me Pr/Vendim: *"Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë qëndrës komunitare për familjen nr.6 dhe banesat me qira për komunitetin rom,për vitin 2022."*

Përsëri Znj.Mandija në emër të komisionit shprehet pro.Po ashtu edhe Kryetarët e grupeve. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

9. Vijohet me Pr/Vendim: *"Për disa shtesa në VKB Nr.49,datë 30.10.2020 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave socisle me qira pranë qëndrës komunitare për familjen Nr.6."*

Kryetarët e grupeve Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen dakort.Pasohet me hedhjen në votim të këtij Pr/akti, , ku rezultojnë 29 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën shtesë të rendit të ditës.Pr/Vendim *: "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare për dëme të shkaktuara nga zjarri".* Relaton përsëri Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës . Përsëri kryetarët e grupeve shprehin dakortësi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr Znj.Leqejza e cila shprehet se duke marr shkas nga rritja e cmimeve në përgjithësi por edhe cmimi i naftës,i cili prek pothuajse cdo familje.Ajo rikthen problematikën e transportit publik duke theksuar se shërbimi urban vazhdon të mos jetë efektiv, duke lënë shumë për të dëshiruar.Po ashtu vijohet me mungesën e terminaleve pa rezultate konkrete. Ajo dëshiron të paraqesë një kërkesë të qytetarëve të interesuar,përdorues të rregullt të linjës urbane të qytetit,për zgjatjen e linjë së transportit urban përtej pikës fundore tek ish Fermentimi deri tek rrethrotullimi i varrezave të qytetit.

Znj.Lindita Nika, përcjell një ankësë të përsëritur të banorëve të zonës ku ajo banon, në Lgj. "Adem Jashari" për zaptimin e pronës publike dhe kërkon marrjen e menjëhershme të masave conform ligjit.

Z.Metushi dëshiron të diskutojë për një figurë të madhe të artit shkodran, atë të Kolë Idromenos duke përgëzuar disa të rinj për ndërrmarrjen e një iniciative shumë të bukur në organizimin e një aktiviteti shumë të bukur në qytetin e Shkodrës. Gjithashtu ai përshëndet punën e bërë nga bashkia për pastrin e rrugës K.Idromeno, por ai dëshiron të dijë nëse ekziston një projekt i dytë për unifikimin dhe përmirësimin e zonës.

Fjalën e merr Z.Deda i cili përgjigjet që ka një projekt për zonën në fjalë, i cili do vihet në zbatim shumë shpejt,duke mos cënuar të drejtat e bizneseve që ushtrojnë aktivitet e tyre aty.

Po ashtu edhe në lidhje me shqetësimin e Znj.Leqejza,ai thotë se është plotësisht dakort por ky problem do shihet nga drejtoria përkatëse se cfarë mund të bëhet.Edhe për shqetësimin e Znj.Nika ,mendoj se do ketë ndërhyrje nga ana e bashkisë.

Z.Hallunaj sjell në kujtesë një shqetësim të banorëvetë tre rrugicave që kanë nevojë për ndërhyrje duke theksuar këtu që njëra rrugicë është rregulluar nga vetë banorët me fondet e tyre.

Problem tjetër jane kafshët endacake, që nuk po gjejnë zgjidhje.Shqetësues është edhe fakti i mospasjes së banjove publike në qytet.

Tjetër problematikë është edhe rendi në Shkodër dhe ai propozon një takim me Drejtorin e Policisë nëse është e mundur.

Fjalën e merr Z.Hasaj,i cili rikthen në vëmendje problemin shkollën Ismet Salibrucaj ,të cilës i është premtuar ndërtimi i katër ambjenteve të reja,por nuk ka asgjë konkrete.

Tjeter shqetësim është edhe vendi i koshave të mbeturinave.

Z.Deda shprehet se do përgjigjet sapo të ketë information për këto cështje.Ai premton përgjigje në mbledhjen e rradhës ose me shkresë. Kurse përsa i përket qeneve endacakë, dihet tashmë që qytetet e tjera i transportojnë ato drejt Shkodrës dhe asnjë masë nuk është ndërrmarrë nga policia edhe pse kemi pasur një takim në Prefekturë për këtë problem.

Edhe për sa i përket problemit të shkollës,do informohem dhe do vi me një përgjigje .

Kryetarja e Këshillit Znj.Truma deklaron të mbyllur mbledhjen.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 10.05.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 6 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESHA

KRYETARE

Brisela KADIJA